



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 2468 prot.

Tiranë, më 3.07.2023

VENDIM

Nr. 49, datë 03.07.2023

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE
(AMA)**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma "e" të ligjit nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA),

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vendimi i AMA-s nr. 209, datë 16.09.2016 "*Për miratimin e rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive*", i ndryshuar me vendimin e AMA-s nr. 120, datë 08.06.2018, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:
Zëvendëskryetar:
Anëtarë:

Armela
Desada
Aurela
Besian
Gjergji
Jetmir
Joana

KRASNIQI
METAJ
BICJA
ZOGAJ
HAMITI
HALILAJ
ALLUSHI



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Face 1

RREGULLORE E AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE (AMA)

(Miratuar me vendimin nr. 49, datë 03.07.2023 të AMA-s)

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin në mënyrë të detajuar të funksionimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (këtej e tutje AMA), me qëllim përcaktimin e normave të zbatueshme për mbledhjen, ushtrimin e veprimtarisë, votimin dhe zbatimin e vendimeve të këtij organi kolegjal, në përmbushjen e detyrave që lindin nga ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 2
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 3
Baza ligjore

1. Rregullorja e AMA-s është një dokument administrativ që hartohet dhe miratohet në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Kjo rregullore del në përputhje e për zbatim edhe të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, legjislacionit në fuqi për organet kolegjinale, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore, që nuk bien ndesh me ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.



Neni 4

Parimet e veprimtarisë së AMA-s

1. AMA, gjatë ushtrimit të funksionit dhe kryerjes së detyrave, respekton parimet e:
 - a. Ligjshmërisë;
 - b. Barazisë dhe mosdiskriminimit;
 - c. Pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;
 - d. Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit;
 - e. Parimi i proporcionalitetit;
 - f. Shqyrtimit brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme;
 - g. Transparencës dhe informimit të publikut;
 - h. Parimin e objektivitetit.

Face | 2

KREU II

STATUSI DHE PËRBËRJA E AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Neni 5

Statusi dhe përbërja e AMA-s

1. AMA është person juridik publik, i krijuar me ligj dhe i pavarur, me seli në Tiranë.
2. AMA përbëhet nga shtatë anëtarë, përfshirë Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin.
3. Mënyra e krijimit, zgjedhja e Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe e pesë anëtarëve, objektivat dhe funksionet e AMA-s rregullohen në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 6

Ushtrimi i funksioneve dhe kompetencave

1. AMA ushtron gjatë mbledhjes së tij funksionet dhe kompetencat e parashikuara në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. AMA ushtron edhe çdo funksion dhe kompetencë, që i ngarkohet nga legjislacioni tjetër në fuqi, brenda fushës së veprimtarisë së tij.
3. Gjatë ushtrimit të detyrës pranë AMA-s, Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e AMA-s përfitojnë pagë dhe përfitime sipas parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi për pagat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura të krijuara me ligj.

Neni 7

Vula e AMA-s

1. AMA ka vulën e tij zyrtare, e cila është në formë të rrumbullakët dhe përmban stemën e Republikës, e rrethuar nga teksti “Republika e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive”.
2. Vula ruhet dhe administrohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Qëndrimet dhe përgjegjësia personale të anëtarëve

1. Anëtarët e AMA-s nuk mbajnë përgjegjësi për vendime, opinione dhe veprime të ndërmarra në mënyrë kolegjiale.
2. Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e AMA-s kanë të drejtë të mbajnë qëndrime publike në rastet, kur:
 - a) veprimtaria e Autoritetit nuk është pasqyruar drejt në media.
 - b) cënohet imazhi publik i AMA-s.
 - c) në çdo rast tjetër, që çmohet nga ana e AMA-s.

KREU III

THIRRJA E MBLEDHJEVE

Neni 9

Mbledhjet e AMA-s

1. Kryetari i AMA-s propozon për datën dhe kohën e mbledhjes të AMA-s. AMA mbledhet të paktën dy herë në muaj, në përmbushje të detyrave të përcaktuara në ligjin organik. AMA mund të mbledhet edhe më shpesh, në varësi të çështjeve që kërkohet të shqyrtohen për sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të institucionit.
2. Mbledhja e AMA-s drejtohet nga Kryetari. Kur Kryetari është në mungesë për shkaqe objektive të njoftuara prej tij, mbledhja drejtohet nga Zëvendëskryetari i AMA-s, nëse përmbushen kriteret sipas pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Në rastin kur pozicionet e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit janë vakante njëkohësisht, mbledhja drejtohet nga anëtari i AMA-s më i vjetër në moshë, deri në plotësimin e të paktën njërit vend vakant.
4. Mbledhja e AMA-s quhet e vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë. Në rastet kur nuk plotësohet kuorumi, Kryetari shtyn mbledhjen në një datë tjetër, të paktën 24 orë pas datës së të parës. Në qoftë se edhe në këtë rast, në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica absolute e anëtarëve, Kryetari i AMA-s vendos shtyrjen e mbledhjes për një datë tjetër, duke e caktuar datën e re të mbledhjes në çdo rast, jo më vonë se muaji pasardhës.
5. Si rregull, mbledhja e AMA-s zhvillohet në selinë, ku Autoriteti ushtron veprimtarinë e tij të përditshme, me përjashtim të rastit kur Kryetari vendos ndryshe.
6. Mbledhja zhvillohet me pjesëmarrjen fizike të anëtarëve.
7. Përjashtimisht, mbledhjet e AMA-s mund të zhvillohen edhe online, vetëm në rastet kur mundësohet pjesëmarrja e shumicës absolute të anëtarëve dhe garantohet, për aq sa është e mundur, zbatimi i rregullave të Kreut IV të kësaj rregulloreje.
8. Në rastet e mbledhjeve online, kur anëtari nuk mund të firmosë aktet brenda 48 orëve, nuk merr pjesë në mbledhje.
9. Në çdo rast, pjesëmarrja në distancë nuk lejohet për rastet, kur në mbledhje diskutohen të dhëna personale, konfidenciale ose sekrete.

Neni 10

Thirrja e mbledhjeve

1. Mbledhjet e AMA-s thirren me nismën e Kryetarit, i cili propozon rendin e ditës. Në rendin e ditës përfshihen çështje dhe vendimmarrje të cilat, në zbatim të ligjit, janë pjesë e funksioneve dhe kompetencave të AMA-s. Face | 4
2. Referuar pikës 1, të drejtën për të kërkuar shqyrtimin e çështjeve në rendin e ditës së mbledhjes të AMA-s e ka secili prej anëtarëve të Autoritetit. Në këtë rast, kërkesa paraqitet me shkrim dhe depozitohet brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit për thirrjen e mbledhjes, ose në çdo kohë në mungesë të njoftimit për mbledhjen e radhës. Kërkesa me shkrim administrohet nga Sekretariati Teknik i AMA-s. Çështja përfshihet në rendin e ditës kur kërkesa miratohet me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të AMA-s.
3. Mbledhja e AMA-s thirret duke komunikuar kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes. Njoftimi për thirrjen e mbledhjeve të AMA-s kryhet nga Sekretariati Teknik, jo më vonë se 48 orë përpara datës dhe kohës së vendosur për mbajtjen e mbledhjes. Lajmërimi për mbledhje shoqërohet së bashku me materialet për shqyrtim për të gjithë anëtarët.
4. Lajmërimi i mbledhjes dërgohet nga Sekretariati në formë shkresore, kundrejt nënshkrimit në regjistrin e posaçëm të protokollit.
5. Në rastet e mungesës së anëtarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, ky fakt evidentohet në regjistrin e posaçëm të protokollit dhe njoftimi kryhet në formë elektronike në adresën zyrtare të anëtarit.
6. Çdo anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive depoziton në formë të shkruar pranë Sekretariatit Teknik adresën e vendbanimit/ vendqëndrimit ose ushtrimit të profesionit, adresën elektronike, kontaktet e tij telefonike dhe mënyrën e njoftimit, të cilat ai i zgjedh si të përshtatshme për të marrë njoftimet për zhvillimin e mbledhjeve.
7. Çdo ndryshim në të dhënat e parashikuara në pikën 6, depozitohet në të njëjtën formë dhe mënyrë pranë Sekretariatit Teknik të AMA-s. Të dhënat ruhen dhe administrohen nga Sekretariati Teknik i AMA-s në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
8. Data e lajmërimit të anëtarit do të konsiderohet data e dërgimit të lajmërimit në një nga format e përcaktuara në pikën 3 dhe 5 të këtij neni.
9. Çdo ndryshim i vendit, kohës së vendosur apo rendit të ditës, i njoftohet çdo anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive me të njëjtën formë dhe mënyrë të përcaktuar në këtë nen.
10. Në fund të çështjeve të rendit të ditës vendoset edhe një pikë "Të tjera", e cila përfshin raste të tjera për diskutime/shqyrtime/vendime që mund të ngrihen nga anëtarët gjatë mbledhjes. Në çdo rast, për çështjet e përfshira në pikën "Të tjera", qëndrimet e anëtarëve pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Nëse çmohet e arsyeshme prej tyre, anëtarët e AMA-s rezervojnë të drejtën e kërkesës së informacionit, apo dokumentave shtesë nga anëtarit, i cili ka hedhur në diskutim çështjen.
11. Nëse çështjet e rendit të ditës nuk arrijnë të shqyrtohen brenda ditës së mbledhjes, AMA vendos vazhdimin e mbledhjes në një ditë tjetër, ose përfshirjen e çështjeve në mbledhjen e ardhshme të saj.

Neni 11

Thirrja e mbledhjeve jashtë radhe

1. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 anëtarë të AMA-s, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Kërkesa me shkrim administrohet nga Sekretariati Teknik i AMA-s, sipas dispozitave të rregullores në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik.
2. Në këto raste, njoftimi për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme dhe rendi i ditës së saj u njoftohen brenda 24 orëve anëtarëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në njërën nga mënyrat dhe mjetet e njoftimit, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.
3. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje jashtë radhe duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.
4. Kryetari i AMA-s, kur çmon të nevojshme, mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të AMA-s.
5. Mënyra dhe koha e njoftimit të anëtarëve të AMA-s për thirrjen e mbledhjes dhe rendin e ditës, në rastet e mbledhjeve të jashtëzakonshme, parashikohet në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

Page | 5

Neni 12

Thirrja e mbledhjes në kundërshtim me rregullin

1. Mbledhja e Autoritetit të Mediave Audiovizive është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët me të drejtë vote, të cilët paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.

Neni 13

Publiciteti i mbledhjeve

1. Mbledhjet e AMA-s, si rregull, nuk zhvillohen të hapura, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.
2. Vendimmarrjet e AMA-s publikohen menjëherë pas përfundimit të mbledhjes në faqen zyrtare të Autoritetit, nëpërmjet njoftimeve për shtyp.
3. Mbledhjet zhvillohen të hapura kur kjo vendoset nga AMA, në rastet kur e çmon të arsyeshme.

KREU IV

SHQYRTIMI I ÇËSHTJEVE, VOTIMI GJATË MBLEDHJEVE TË AMA-S

Neni 14

Shqyrtimi i çështjeve të rendit të ditës

1. Në mbledhjen e AMA-s, çështjet e rendit të ditës shqyrtohen sipas renditjes së pasqyruar në materialet bashkëlidhur njoftimit, që u janë shpërndarë anëtarëve të AMA-s.

2. Me propozimin e Kryetarit ose njërit prej anëtarëve të Autoritetit, si dhe me miratimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm, një çështje mund të shqyrtohet edhe jashtë renditjes që ajo ka në rendin e ditës.

Neni 15

Dokumentacioni shoqërues

Face | 6

1. Çdo çështje që është pjesë e rendit të ditës të mbledhjes së AMA-s, shoqërohet me dokumentacionin shpjegues përkatës, të hartuar nga ana e administratës së Autoritetit, Këshillit të Ankesave ose subjektit propozues.
2. Në çdo rast, kur kërkohet vendimmarrja e AMA-s në përmbushje të funksioneve që i njeh ligji, projekt-vendimi i hartuar, shoqërohet me relacion shpjegues të nënshkruar nga strukturat përgjegjëse të administratës së AMA-s, Këshillit të Ankesave ose subjektit propozues, i cili duhet të përmbajë, të paktën, objektin, rrethanat e faktit, bazën ligjore, analizën ligjore dhe propozimin e AMA-s. Në rast të kundërt, projekt-vendimi nuk merret në shqyrtim.
3. Sekretariati Teknik i AMA-s koordinon punën me strukturat përgjegjëse të administratës dhe Këshillit të Ankesave për përgatitjen e projekt-vendimeve dhe dokumentacionit shoqërues, sipas standardeve dhe formatit të miratuar.

Neni 16

Mënyra e shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës dhe mbështetja administrative

1. Nën drejtimin e Kryetarit të AMA-s, sipas renditjes së çështjeve në rendin e ditës, organi i shqyrton ato në praninë e përfaqësuesve të administratës së Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe sipas rastit, të Këshillit të Ankesave.
2. Administrata e AMA-s siguron mbështetje administrative gjatë mbledhjeve të Autoritetit, sipas rastit.
3. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe anëtarët e AMA-s, gjatë shqyrtimit të çështjeve kanë të drejtë të diskutojnë, të drejtojnë pyetje, të kërkojnë materiale apo sqarime nga ana e përfaqësuesve të administratës së Autoritetit dhe Këshillit të Ankesave në lidhje me tematikat konkrete.

Neni 17

Të drejtat e subjekteve të interesuara në shqyrtimin e çështjeve

1. Gjatë shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës, kur ligji e parashikon pjesëmarrjen e tyre, AMA u garanton subjekteve të interesuara të gjitha të drejtat që parashikohen në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, si dhe siguron zbatimin e parimit të procesit të rregullt, duke u kujdesur për plotësimin e kërkesave dhe kritereve që parashikon Kodi i Procedurave Administrative.

Neni 18

Votimi i detyrueshëm

1. Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Autoritetit të Mediave Audiovizive, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave, nuk mund të abstenojnë.
2. Referuar pikës 1, anëtari i AMA-s i pranishëm në mbledhje nuk mund të heqë dorë nga votimi, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë pengesa ligjore, të tilla si konflikti i interesit ose pengesa të tjera ligjore, të parashikuara në nenet 20 dhe 21 të kësaj rregulloreje.

Page 7

Neni 19

Zbatimi i Kodit të Sjelljes së AMA-s

1. Gjatë zhvillimit të mbledhjes, në shqyrtimin e çështjeve dhe në procesin e votimit, Kryetari, Zëvendëskryetari dhe anëtarët e AMA-s iu referohen dhe zbatojnë parimet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Sjelljes së AMA-s.
2. Anëtarët e AMA-s mund të angazhohen në veprimtari që nuk lidhen me funksionin e tyre në AMA, për aq sa nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, ose me këtë rregullore.
3. Në çdo rast dhe situatë që mund të krijohet gjatë ushtrimit të funksionit, anëtarët e AMA-s duhet të deklarojnë dhe të shmangin kryerjen e detyrës në kushtet e papajtueshmërisë ligjore ose konfliktit të interesave, ose çdo rrethanë tjetër të parashikuar si ndalesë në legjislacionin në fuqi, me qëllim ruajtjen e parimit të paanshmërisë dhe ligjshmërisë në veprimtarinë e Autoritetit.
4. Anëtarët e AMA-s nuk mund të zbulojnë apo përdorin qëllimisht, informacione jopublike me të cilat janë njohur gjatë detyrave të tyre si anëtarë, për ndonjë qëllim tjetër, që nuk lidhet me funksionin e tyre në AMA, edhe pas largimit nga detyra.

Neni 20

Mospërfshirja në votim në rastet e konfliktit të interesit

1. Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e AMA-s që janë të pranishëm në mbledhje dhe pretendojnë së janë në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative ose konfliktit të interesave, apo çdo situatë të ngjashme të parashikuar në Kodin e Sjelljes së AMA-s, për të mos u përfshirë në votim për njërën nga çështjet e rendit të ditës, e parashtrajnë këtë fakt në fillim të shqyrtimit të çështjes përkatëse, duke u pasqyruar ky fakt në procesverbalin e mbledhjes.
2. Në rastet e konfliktit të interesit sipas pikës 1 të këtij neni, anëtari kërkon heqjen dorë nga diskutimi ose votimi.
3. Në rastet e mospërfshirjes në votim për shkak të pengesës ligjore ose konfliktit të interesave, Kryetari, zëvendëskryetari ose anëtari përkatës i Autoritetit nuk marrin pjesë gjatë diskutimeve të çështjes përkatëse.

Neni 21

Përfshirja nga votimi

1. Kur janë depozituar kërkesa për ekzistencën e pengesave ligjore ose konfliktit të interesave të anëtarëve të AMA-s në shqyrtimin e çështjeve të rendit të ditës nga subjekte të interesuara, Kryetari i AMA-s i parashtron ato, së bashku me provat që i bashkëngjiten kërkesës për përfshirje.
2. Në këto raste, përpara fillimit të shqyrtimit të çështjes votohet për përfshirjen ose jo nga votimi të anëtarit përkatës të AMA-s.
3. Anëtar i AMA-s për të cilin kërkohet përfshirja nga votimi, nuk merr pjesë në votimin e kërkesës.
4. Në rastet e përfshirjes nga votimi për shkak të pengesës ligjore, Kryetari, zëvendëskryetari ose anëtar i përkatës i AMA-s nuk marrin pjesë gjatë diskutimeve të çështjes.

Page 8

Neni 22

Format e votimit

1. AMA i merr vendimet me votim të hapur.
2. Vota deklarohet verbalisht nga secili anëtar i AMA-s me të drejtë vote.
3. Përfshirjes, në rastet e votimit për çështje që lidhen me anëtarë të tij, individë, ose të dhëna personale apo sekrete, vendimet merren me votim të fshehtë.
4. Në çdo rast, Kryetari i AMA-s voton i fundit.
5. Kur votimi bëhet sipas pikës 3 të këtij neni, fleta e votimit përmban:
 - a) çështjen, për të cilën votohet,
 - b) hapësirën e votimit, ku anëtar i përcakton votën e tij pro ose kundër propozimit,
 - c) hapësirën, ku anëtar i shënon emrin dhe mbiemrin e tij.
6. Në përfundim të votimit të fshehtë, Sekretariati Teknik mbledh fletët e votimit dhe shpall rezultatin.

Neni 23

Vlefshmëria e vendimeve

1. AMA i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje, me përfshirje të rasteve kur në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, parashikohet shumicë e cilituar.
2. Vendimet lidhur me çështje që kërkojnë mendim institucional të Autoritetit, të cilat Kryetari duhet t'i dërgojë për mendim e diskutim anëtarëve të AMA, merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.

Neni 24

Barazia e votave

1. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e Kryetarit është vendimtare.

2. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi shtyhet për mbledhjen tjetër.
3. Në qoftë se në votimin e parë të mbledhjes tjetër ka përsëri një barazi votash, kryhet votim i hapur.

KREU V

Face 9

VENDIMMARRJA E AMA-S, FORMA, NJOFTIMI DHE BOTIMI I VENDIMEVE

Neni 25

Sekretariati Teknik i AMA-s

1. Pranë AMA-s, në funksion të mirëorganizimit dhe mbarëvajtjes së mbledhjes së organit kolegjal, ngrihet dhe funksionon Sekretariati Teknik, i drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe dy nënpunës të administratës të caktuar me urdhër prej tij.
2. Në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm, përbërja e Sekretariatit Teknik caktohet me urdhër të Kryetarit të AMA-s.

Neni 26

Procesverbali dhe regjistrimi audio i mbledhjes

1. Mbledhjet e AMA-s dokumentohen përmes procesverbalit të zbardhjes së regjistrimit audio të mbledhjes, që ruhet për 30 ditë.
2. Sekretariati Teknik i AMA-s është përgjegjës dhe merr masat e nevojshme për regjistrimin audio dhe zbardhjen e procesverbalit të mbledhjes së Autoritetit.
3. Në procesverbalin e mbledhjes pasqyrohet, data, koha dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, rendi i ditës, çështjet që janë diskutuar, diskutimet e pjesëmarrësve, propozimet e bëra, vendimet e marra, forma, rezultati dhe mënyra e votimit nga çdo anëtar.
4. Çdo anëtar i AMA-s mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti se ai ka votuar kundër vendimit të marrë, si dhe të paraqesë arsyetimin për votën kundër.
5. Procesverbali i mbledhjes dhe vendimet e marra duhet të zbardhen brenda 7 ditëve nga përfundimi i mbledhjes.
6. Procesverbali mbahet nga anëtari i Sekretariatit Teknik i ngarkuar me këtë detyrë dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku, nga Kryetari i AMA-s dhe anëtari i Sekretariatit Teknik, i ngarkuar për mbajtjen e tij.
7. Çdo anëtar i AMA-s ka të drejtë të verifikojë përmbajtjen e procesverbalit dhe të paraqesë pretendimet e tij, që parashtrihen në mbledhjen pasardhëse. Në qoftë konfirmohet pasaktësia e zbardhjes, procesverbali i mbledhjes së AMA-s korrigjohet në një prej mënyrave të mëposhtme:
 - a) me urdhër të Kryetarit;
 - b) me vendim të AMA-s, në mbledhjen pasuese.
8. Vendimet e AMA-s, së bashku me regjistrimet audio dhe procesverbalet e zbardhura të mbledhjeve depozitohen pranë këtij Autoriteti.
9. Sekretariati Teknik i AMA-s merr masat e duhura për katalogimin, ruajtjen dhe arkivimin e të gjithë dokumentacionit të mbledhjeve që depozitohen pranë Autoritetit.



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Rruga "Papa Gjon Pali II", 1010, Tiranë | www.ama.gov.al
Tel. +355 4 2233370 | Email. info@ama.gov.al

Neni 27

Vendimmarrja e AMA-s

1. Në përfundim të shqyrtimit të çdo çështjeje të rendit të ditës, në rastet kur në përmbushje të funksioneve të dhëna me ligj, kërkohet vendimmarrje e Autoritetit të Medias Audiovizive, në përputhje me formën dhe mënyrën e votimit, Autoriteti shprehet me vendim të arsyetuar, sipas përmbajtjes së parashikuar në nenin 35 të kësaj rregulloreje.
2. AMA pas shqyrtimit të ankimit administrativ, vendos:
 - a. Pranimin e ankimit:
 - kur vërtetohen pretendimet e ankuesit se të drejtat apo interesat e tij të ligjshme cenohen nga veprimet apo mosveprimet e organit publik;
 - kur akti administrativ që kundërshtohet është miratuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - b. Rrëzimin e ankimit, duke argumentuar zbatimin e drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet e inspektorëve të Autoritetit të Mediave Audiovizive, apo strukturave të tjera.
3. Anëtarët e AMA-s që kanë votuar kundër vendimit të miratuar nga autoriteti, mund të arsyetojnë votën e tyre.

Neni 28

Përmbajtja dhe hyrja në fuqi e vendimit të AMA-s

1. Vendimi i AMA-s përbëhet nga :
 - a) pjesa hyrëse, që përmban:
 - i) emrin e Autoritetit që nxjerr vendimin;
 - ii) palët të cilave u drejtohet vendimi;
 - iii) datën e miratimit;
 - iv) bazën ligjore;
 - b) pjesën arsyetuese.
 - c) dispozitivin që tregon:
 - i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;
 - ii) kohën e hyrjes në fuqi të vendimit;
 - iii) të drejtën e ankimit, në rastet kur kjo e drejtë parashikohet në ligj, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.
2. Vendimi përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të anëtarëve të AMA-s dhe vulën e Autoritetit.
3. Vendimet mbi aktet normative të hartuara nga AMA kur parashikohen në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, hyjnë në fuqi menjëherë me miratimin e tyre dhe botohen në Fletoren Zyrtare.
4. Vendimet e tjera të AMA-s hyjnë në fuqi menjëherë.

Neni 29

Zbatimi i vendimeve

1. Vendimet e AMA-s, të nxjerra në zbatim të funksioneve ligjore zbatohen sipas rastit, nga ana e administratës së Autoritetit ose organet e tjera përgjegjëse ligjzbatuese, si dhe subjektet të cilave iu drejtohen.

Page | 11

Neni 30

Njoftimi i subjekteve

1. Vendimet e AMA-s të cilat u drejtohen ose sjellin pasoja juridike për subjektet e interesuara, u njoftohen atyre brenda 5 ditëve nga dita e daljes së vendimit, në një ose disa nga format e mëposhtme:

- a) me komunikim shkresor, të përcjellë me postë të porositur, në adresën e paraqitur nga subjekti, ose në adresën e përfaqësuesit ligjor të tij, kur kjo është bërë e ditur zyrtarisht nga subjekti;
- b) në adresën postare elektronike, të depozituar nga subjekti ose përfaqësuesi ligjor i tij.

KREU VI

MARRËDHËNIET E AMA-S ME PALË TË TRETA

Neni 31

Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. AMA bashkëpunon me organe të ndryshme të administratës shtetërore, gjykata, organe përfaqësuese brenda sektorit të mediave audiovizive, gjatë zbatimit të detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 97/2013, i ndryshuar.
2. AMA bashkëpunon me organet homologe të shteteve të tjera, kur e vlerëson të nevojshme për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 97/2013, i ndryshuar.

Neni 32

Funksionet promovuese të AMA-s

1. AMA nxit OSHMA-të në përgatitjen e kodeve të sjelljes që përcaktojnë standardet dhe praktikat që respektohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike, të cilët ofrojnë shërbime mediatike audio dhe audiovizive.
2. AMA, për aq sa është e mundur, si dhe në bashkëpunim me organet homologe të shteteve të tjera, nxit ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove në përgatitjen e kodeve të sjelljes që përcaktojnë standardet dhe praktikat që respektohen nga këto platforma
3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, për aq sa është e mundur, AMA promovon dhe nxit ndërgjegjësimin publik, kërkimin dhe veprimtaritë lidhur me edukimin mediatik, përfshirë ndërgjegjësimin publik për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove.

Neni 33
Aksesueshmëria në kontaktin me AMA-n

1. AMA cakton në faqen e tij zyrtare një person kontakti të posaçëm, lehtësisht të arritshëm nga të gjithë qytetarët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, për dhënien e informacionit dhe marrjen e ankesave drejtuar institucionit në formën më të dobishme për ta.
2. Pika e kontaktit sipas pikës 1 të këtij neni, caktohet nga rradhët e punonjësve të institucionit që kanë përvojë dhe njohuri mbi marrëdhëniet me publikun.

Face | 12

Neni 34
Parashikime të fundit

1. Rregullorja e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016 të AMA-s, i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Çdo akt tjetër nënligjor i miratuar nga AMA, që bie ndesh me këtë rregullore, shfuqizohet.

Neni 35
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.